



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR
SEKTORI JURIDIK

Nr. 505/1 Prot.

Tiranë, më 30.11.2022

Lënda: Mendim mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 7675/1 prot., datë 22.11.2022, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", së bashku me praktikën shoqëruese, në zbatim të shkronjës "d", të nenit 16, të ligjit nr. 10433/2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në vijim gjeni vlerësimin e Inspektoratit Qendror.

Nisur nga fusha veprimit të ligjit për inspektimin¹, sugjerojmë që në nenin 12, të projektligjit, sipas të cilit "Në fund të pikës 2, të nenit 69 shtohet togfjalëshi "nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor", në fund të fjalisë të shtohet edhe togfjalëshi "sipas ligjit për inspektimin".

Gjithashtu, po në nenin 12 të projektligjit, lidhur me ndryshimet e propozuara në nenet 70 dhe 71 të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, sugjerojmë:

- Pas pikës 3, të nenit 70, të shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:
"3.1. Procedura që ndiqet nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, rregullohet nga ligji për inspektimin."
- Në pikën 1, të nenit 71, pas fjalëve "institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor", të shtohet togfjalëshi "sipas ligjit për inspektimin".

Me sugjerimet e mësipërme, projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" vlerësohet konform legjislacionit për inspektimin.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
SHKËMBIMHAJDARI

¹ Përcaktuar në nenin 2, sipas të cilit ky ligj është zbatueshëm për të gjitha institucionet, që kryejnë funksione inspektimi